

# Progresi dhe Perspektivat: Vlerësimi i Gjendjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë

Dhjetor, 2023





# **Progresi dhe Perspektivat: Vlerësimi i Gjendjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë**

Dhjetor, 2023

Autor: INDEP

Programi: Zhvillim I Qëndrueshëm

Publikuar: Dhjetor, 2023



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

#### **Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.



**Rockefeller  
Brothers Fund**  
Philanthropy for an Interdependent World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet e autorëve nuk shprehin ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF.

---



# PËRMBAJTJA


<b>HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>OZHQ 1: PA VARFËRI</b>	<b>5</b>
<b>OZHQ 2: ZERO URI</b>	<b>8</b>
<b>OZHQ 3: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE</b>	<b>10</b>
<b>OZHQ 4: ARSIM CILËSOR</b>	<b>12</b>
<b>OZHQ 5: BARAZI GJINORE</b>	<b>16</b>
<b>OZHQ 6: UJË I PASTËR DHE KANALIZIME</b>	<b>20</b>
<b>OZHQ 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËRT</b>	<b>23</b>
<b>OZHQ 8: PUNË DINJITOZE DHE RRIJJE EKONOMIKE</b>	<b>27</b>
<b>OZHQ 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË</b>	<b>31</b>
<b>OZHQ 10: ZVOGËLIM I PABARAZIVE</b>	<b>34</b>
<b>OZHQ 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME</b>	<b>38</b>
<b>OZHQ 12: KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM</b>	<b>41</b>
<b>OZHQ 13: VEPRIMI PËR KLIMËN</b>	<b>44</b>
<b>OZHQ 15: JETA NË TOKË</b>	<b>47</b>
<b>OZHQ 16: PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA</b>	<b>50</b>
<b>OZHQ 17: PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT</b>	<b>53</b>
<b>REKOMANDIME PËR 4 OZHQ-TË PRIORITARE</b>	<b>56</b>



**4**

OZHQ  
PRIORITARE

Në këtë raport progresi, ne theksojmë 4 objektiva të cilat në mendojmë se duhet t'i japim prioritet



Shëndet i mirë dhe mirëqenie



Pa varfëri



Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike



Veprimi për klimën

## Mungesa e të dhënave \*



Të dhënat e disponueshme i mbulojnë vetëm 33% të indikatorëve



Nuk ka të dhënat për 44% të indikatorëve




25% e indikatorëve nuk janë relevant për Kosovën

# HYRJE

Brenda strukturës komplekse të historisë së pas-pavarësisë së Kosovës, ndjekja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) është bërë një shtyllë mbështetëse dhe një lloj matësi që tregon rrugën drejt një të ardhmeje më të drejtë dhe më të qëndrueshme. Kosova ka negociuar ndërveprimin e ndërlikuar të trashëgimive historike, kufizimeve ekonomike dhe aspiratave shoqërore që nga fitimi i pavarësisë në vitin 2008. Kosova tani ka një kornizë universale për të adresuar rrjetën komplekse të çështjeve që krijojnë narrativën e saj zhvillimore falë një mandati global të mishëruar në 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat u miratuan nga Kombet e Bashkuara në 2015.

Objektivat kryesorë të rrugëtimit zhvillimor të Kosovës janë reduktimi i varfërisë (OZHQ 1), shëndeti i mirë dhe mirëqenia (OZHQ 3), avancimi i punësimit të respektueshëm dhe zgjerimi ekonomik (OZHQ 8) dhe veprimi për klimën (OZHQ 13). Pavarësisht se po përjeton disa brishtësi ekonomike, Kosova është duke bërë përpjekje për të diversifikuar ekonominë e saj. Trajektorja ekonomike e Kosovës është formësuar dukshëm nga disa iniciativa të reja të ndërmarrësisë dhe investimet ndërkombëtare, duke u përpjekur për t'iu përkushtuar ndaj rritjes së barabartë që është në përputhje me OZHQ-të. Kjo këmbëngulje ekonomike shërben si dëshmi e vendosmërisë së Kosovës për t'iu marrë jo vetëm me çështjet aktuale, por edhe për të vendosur bazat për sukses afatgjatë. Një rritje ekonomike e qëndrueshme do të ishte shtysë edhe për përmbushjen e OZHQ-ve të tjera.

Një pjesë e rëndësishme e narrativës zhvillimore të Kosovës është përmirësimi i cilësisë së arsimit, që rezonon me OZHQ 4. Kosova deri më tani ka treguar një progres të ngadaltë në përmbushjen e kësaj objektivë. Demonstruesi më i mirë i kësaj janë rezultatet e dobëta në testin PISA. Kjo vjen si pasojë e problemeve të shumta me stafin akademik të institucioneve arsimore, moszbatimi i kurrikulës së re dhe mungesës së mekanizmave për sigurimin e cilësisë.







Sfidë tjetër në këtë drejtim vazhdon të jetë edhe mospërputhja e kërkesave të tregut me aftësitë dhe njohuritë që fitohen në shkolla, duke krijuar kështu një shoqëri që, mes të tjerash, mund të mos jetë e zhvilluar në aspektin e kulturës politike.

OZHQ-të 6, 7, 11, 13 dhe 15 i referohen të gjitha mbrojtjes mjedisore. Inkurajimi i rritjes ekonomike duke ruajtur qëndrueshmërinë mjedisore është një sfidë me të cilën përballen të gjitha vendet, e sidomos vendet në tranzicion si Kosova. Gjatë vitit të fundit Kosova ka demonstruar një përkushtim të rritur ndaj përgjegjësisë mjedisore përmes disa iniciativave që kanë për qëllim të sigurojnë energji të përbalueshme dhe të pastër, qytete dhe komunitete të qëndrueshme, veprim klimatik dhe ruajtjen e jetës në tokë. Por këto iniciativa nuk janë të mjaftueshme për ruajtjen e burimeve natyrore për gjeneratat e ardhshme, dhe gjithashtu për të adresuar njëkohësisht çështjet aktuale mjedisore.

Në thelb, progresi i Kosovës drejt OZHQ-ve është një narrativë e qëndrueshmërisë, ndërlidhjes dhe vendosmërisë. OZHQ-të shërbejnë jo vetëm si pikë referimi, por edhe si një vizion i përbashkët që i kapërcen kufijtë, duke përafuar trajektoren zhvillimore të Kosovës me një përkushtim më të gjerë për një botë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Ndërsa thellohemi në faqet e këtij raporti, ai bëhet më shumë se thjesht një dokumentacion progresi; ai shpalos sfidat me të cilat përballemi dhe triumfet e arritura përmes përpjekjeve të përbashkëta. Mes sfidave tona të vazhdueshme, ky raport qëndron si një kujtesë për rëndësinë e reflektimit në rrugën tonë drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Hapat e Kosovës drejt OZHQ-ve, të shtjelluara në këtë raport, jo vetëm që tregojnë për arritjet të rëndësishme, por gjithashtu shërbejnë si burim frymëzimi, duke na shtyrë kolektivisht drejt një të ardhmeje më të ndritshme, më të ndërlidhur për shtetin tonë dhe komunitetin global.





## OZHQ 1: PA VARFËRI

Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj kudo

### Vlerësimi i targeteve

1.1 Në Kosovë sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian për Kosovën, rreth 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë (45 euro në muaj, ku 5.1% e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë ekstreme).

Përqindja e anëtarëve të familjare të cilat në vitin 2021 nuk mund të përballojnë: 1) për të mbajtur shtëpinë ngrohtë në mënyrë adekuate - 14.9%, 2) një javë pushimi larg shtëpisë (56.8%), 3) të hanë mish, peshk os ekuivalent të proteinsë çdo të dytën dite (43.0%), 4) një shpenzim te papritur prej 100€ (43%).

1.2 Mirëqenia sociale është një target që matet në Kosovë nga ASK. Në vitin 2022, 90,806 banorë kanë përfituar nga ndihmat sociale.

1.4 Në vitin 2022 në Kosovë nuk ka ndodhur ndonjë fatkeqësi e madhe natyrore, që ka mundur të shkaktoj vdekje, zhdukje të personave apo ndikim të drejtpërdrejt tek popullsia, por ka pasur rreshje të shumta atmosferike të cilat herë pas here kanë shkaktuar përmytje në disa zona të Kosovës. Por, përveç dëmeve materiale, nuk ka pasur dëme në njerëz. Kosova ka pasur një Strategji për Zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020, e cila nuk është përditësuar për periudhën pas vitit 2020.

### Situata e përgjithshme

Sipas Bankës Botërore, rreth 18% e popullsisë jeton nën kufirin ndërkombëtar të varfërisë (me 45 euro në muaj), me 5.1% përqind të popullsisë nën kufirin e varfërisë ekstreme[1].

Gjatë vitit 2022 në Kosovë, 41.5% e punëkërkuesvë të regjistruar kanë qenë të grup moshës 25-39, gjë që tregon se kemi fuqi punëtore relativisht të re. Por në anën tjetër Kosova ka një shkallë të lartë të varësisë ekonomike, 230 gjatë vitit 2022, që do të thotë se ekziston një barrë e konsiderueshme për popullsinë në moshë pune për të mbështetur ata që janë ekonomikisht të varur. Kjo barrë përkeqësohet akoma më shumë nëse pagat janë të ulëta

Gjatë vitit 2022 ka pasur një rritje relativisht të vogël të pagës mesatare neto në krahasim me vitin 2021, por prap kjo rritje nuk është e mjaftueshme nëse e bëjme vlerësimin në raport me nivelin e inflacionit [2]

Proporcioni i punësimit të paqëndrueshëm në raport me punësimin e përgjithshëm gjatë vitit është ngritur, nga 12.7% në vitin 2021 në 13.3% në vitin 2022. Në anën tjetër shkalla e papunësisë ka shënuar ulje, nga 20.7 % në vitin 2021, në 12.6% në vitin 2022. Kjo mund të jetë rezultat i fazës së pandemisë në 2020-2021, e cila rezultoi në humbje të konsiderueshme të vendeve të punës për qytetarët.

Gjatë vitit 2022 prej meshkujve në moshë pune 49.4% ishin të punësuar, kurse prej femrave në moshë pune 18.4% ishin të punësuar. Sektorët me përqindjen më të lartë të punësimit ishin: Tregtia me 19.3%, ndërtimtaria me 11%, arsimi me 10.8% dhe prodhimi me 8.9%.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave

Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Ligji I Punës

Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social

Ligji për Shërbimet sociale dhe familjare

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti

## Sfidat kryesore

- Siç u paraqit në statistikat më lartë, shkalla e punësimit mes femrave dhe meshkujve ka dallim të madh dhe kjo duhet të adresohet në politikat shtetërore
- Ekonomia joformale dhe punësimi ilegal vazhdon të mbetet sfidë edhe gjatë vitit 2022
- Shkalla e lartë e varësisë ekonomike paraqet një problem të shumëfishtë sepse në njërin anë një numër relativisht i vogël individësh që punojnë do të duhet të mbështesin një numër të madh personash që janë ekonomikisht të varur dhe në anën tjetër, Qeveria ka të ngjarë të ketë nevojë të rrit numrin e “social safety nets” dhe sistemeve mbështetëse për të ndihmuar në kujdesin dhe mbështetjen e popullatës së varur
- Mungesa e aksesit në punësim të qëndrueshëm dhe të denjë mund të kontribuojë në varfëri. Kjo përfshin çështje si shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë dhe sektorët e punësimit informal.



## OZHQ 2: ZERO URI

Eliminimi I urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi I ushqyerjes dhe promovimi I bujqësisë së qëndrueshme

### Vlerësimi i targeteve

2.a Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi përbëjnë 7.4% të BPV-së. Në vitin 2022 vlera totale e subvencioneve për sipërfaqet e tokës bujqësore ishte 36.50 mil €, kurse vlera totale e subvencioneve për sektorin e blegtorisë ishte 11.44 mil € [3]

2.c Në gusht të vitit 2022 inflacioni I ushqimit ishte 19.3%, krahasuar me 3.6% të gushtit të vitit 2021.

### Situata e përgjithshme

Pasiguria ushqimore, një sfidë e përhapur globale, i referohet aksesit të pamjaftueshëm në ushqim të mjaftueshëm, të sigurt dhe ushqyes për një jetë aktive dhe të shëndetshme. Shkaqet e pasigurisë ushqimore janë komplekse, duke filluar nga varfëria dhe pabarazitë ekonomike deri te fatkeqësitë natyrore dhe konfliktet. Në Kosovë këto të fundit fatmirësisht nuk kanë ndikuar ende në zingjirin ushqimor, por varfëria është më se prezente. Në të gjithë botën janë disa kategori shoqërore të cilat janë më të ndijshme se të tjerat (fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit) dhe rrjedhimisht janë në rrezik më të madh nga varfëria dhe nga uria/kequshqyerja

Pandemia ka pasur një ndikim mjaft negativ në ekonominë e Kosovës në përgjithësi, veçanërisht në sektorin e bujqësisë, i cili jep një kontribut të rëndësishëm në BPV-në e shtetit. Kjo mund të shihet nga rënia e pjesëmarrjes së bujqësisë në BPV me 0.31% në fund të 2020 [4]

[3] Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, Lista e përfituesve të granteve dhe subvencioneve. E qasshme këtu: <https://azhb-rks.net/>

[4] INDEP, Kosovo's Food System: Its Sustainability and Missing Policies. E qasshme këtu: <https://www.kas.de/documents/286052/0/Report+21-11-22+Kosovo%E2%80%99s+Food+System%2C+Its+Sustainability+and+Missing+Policies+%28ENG%29.pdf/6cfd3166-30fe-0059-8409-46b5b22185ad?version=1.0&t=1638353322828>

Sipas Anketës së Ekonomive Bujqësore 2022, gjithësej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore është 420,482hektarë, ku pjesën më të madhe e kanë livadhet dhe kullosat me 216,998ha. Kultura që mbillet më së shumti në toka të punueshme vazhdon të mbetet gruri, që përbën 38.4% të tokës.

Meqenëse bujqësia paraqet një kontribut të rëndësishëm në BPV, atëherë rrjedhimisht edhe tregu i punës ndikohet nga bujqësia. Në vitin 2022, pjesëmarrja e bujqësisë në punësimin e përgjithshëm ishte 2.2%.

Për të përmbushur OZHQ-në 2 nuk është e mjaftueshme vetëm të sigurojmë furnizim të mjaftueshëm me ushqim, por duhet ndërtuar edhe një sistem i qëndrueshëm ushqimor që mundëson konsum të produkteve ushqimore me vlera të larta ushqyese, dhe në të njëjtën kohë i adreson çështjet si emetimi i gazrave serrë që vijnë nga sektori i bujqësisë dhe industria ushqimore në përgjithësi.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve

Ligji për ushqim

Ligji për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Ligji për veterinarinë

Ligji për inspektionin bujqësor

Ligji për bujqësinë organike

Ligji për blegtorinë e Kosovës

Ligji për peshkatari dhe akuakulturë

Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural

Ligji për produktet biocide

Ligji për pijet e forta alkoolike

## Sfidat kryesore

- Rreziqet e sigurisë ushqimore shkaktohen nga varfëria dhe papunësia e lartë, bashkë me të ardhura të ulëta, shpenzime të larta ushqimore, varësi të lartë nga remitancat dhe deficite të larta tregtare bujqësore dhe ushqimore.
- Kapacitetet institucionale të pamjaftueshme për zbatimin e politikave dhe strategjive të qëndrueshme të bujqësisë dhe sigurisë së ushqimit.
- Dixhitalizimi dhe monitorimi i sistemit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë
- Norma e inflacionit të ushqimit në vitin 2022 në Kosovë ishte 19.3%, prekur produktet ushqimore bazë dhe grupet më të cenueshme të shoqërisë.



## OZHQ 3: : SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

### Vlerësimi i targeteve

3.2. Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve, 16 për 1000 sipas të dhënave të MICS, është katër herë më e lartë se mesatarja e BE-së. Është gati dy herë më i lartë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (27 fëmijë për 1000)[5]

3.7. Gjatë vitit 2022 ishin gjithësej 414 raste të lindjeve në moshë të adoleshencës dhe një lindje në moshë 14 e më pak

### Situata e përgjithshme

Një shoqëri e lulëzuar është e ndërtuar mbi politika të qëndrueshme të kujdesit shëndetësor. Politika të tilla garantojnë që të gjithë të kenë akses në kujdesin shëndetësor me cilësi të lartë, duke mbrojtur mirëqenien e çdo qytetari. Për më tepër, politikat e fuqishme të kujdesit shëndetësor janë thelbësore për adresimin e ndryshimeve demografike dhe sfidave të reja shëndetësore. Pa politika të shëndosha të kujdesit shëndetësor, popullatat e cenueshme mund të vuajnë, pabarazitë zgjerohen dhe shëndeti i përgjithshëm i popullsisë rrezikohet.

Fatkeqësisht politikat jo-adekuate shëndetësore, pajisjet e pamjaftueshme në spitale dhe numri i pamjaftueshëm i stafit mjekësor në spitale publike, i detyron qytetarët të drejtohen drejt institucioneve private të shëndetësisë. Numri i institucioneve private të licencuara në Kosovë është 2095, ku prej tyre më së shumti ka ambulanca stomatologjike. Përveç në sektorin privat, shërbimet stomatologjike ofrohen edhe në Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës, ku gjatë vitit 2022 kjo qendër kishte ofruar 198,776 shërbime.

Njëra ndër shërbimet që ka më së shumti kërkesa për t'u ofruar në spitale të Kosovës janë shërbimet radiologjike. fatkeqësisht gjysma e shërbimeve radiologjike ofrohen vetëm në QKUK, që do të thotë se qytetarët nga komunat tjera duhet të vijnë në Prishtinë për të hyrë në listën e gjatë të pritjes bashkë me qytetarët e Prishtinës.

Ky problem, dhe shumë probleme të tjera, duhet të adresohen në një verzion të përditësuar të Strategjisë Sektoriale e Shëndetësisë.



## Ligjet që përfshijnë këtë objektive

Ligji për çmimin  
e produkteve  
medicinale

Ligji për  
parandalimin dhe  
kontrollimin e  
sëmundjeve  
ngjitëse

Ligji për  
inspektoratin  
Sanitar të  
Kosovës

Ligji për  
Shëndetin  
Mendor

Ligji për  
Shëndetsi

Ligji për sigurime  
shëndetsore

Ligji për Kryqin e  
Kuq të Kosovës

Ligji për  
Shëndetsinë  
Publike

## Sfidat kryesore

- Njëra ndër sfidat që e ka shoqëruar dhe vazhdon ta shoqëroj sistemin shëndetësor të Kosovës përgjatë viteve është mungesa e pajisjeve dhe infrastruktura e objekteve të klinikave;
- Mungesa e profesionistëve të kujdesit shëndetësor në Kosovë, duke përfshirë mjekë, infermierë dhe punëtorë të tjerë të specializuar të kujdesit shëndetësor. Kjo mungesë mund të sforcojë sistemin dhe të çojë në pritje më të gjata për takime dhe procedura.
- Akses të pabarabartë në shërbime mjeksore. Ka pabarazi rajonale në aksesin në shërbimet e kujdesit shëndetësor, ku zonat urbane përgjithësisht kanë akses më të mirë në krahasim me rajonet rurale dhe të largëta.
- Qasje në sistemet e Informacionit Shëndetësor. Mbledhja, menaxhimi dhe shpërndarja e të dhënave shëndetësore mund të jetë sfiduese. Një sistem i fuqishëm informacioni shëndetësor është thelbësor për planifikimin dhe vendimmarrjen efektive të kujdesit shëndetësor.



## OZHQ 4: ARSIM CILËSOR

Sigurimi arsmi cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë

### Vlerësimi i targeteve

4.2. Numri i fëmijëve të regjistruar në në arsimin parashkollor ( fëmijët e moshës 0 – 4 vjet) gjatë periudhës 2022/2023 ishte 5420, kurse në arsimin parafillor ( fëmijët e moshës 5 vjet) 18,946.

4.3. Numri i studentëve të regjistruar në nivelin bachelor në periudhën 2020/2012 ishte 9954, ku femrat kanë dominuar kundrejt meshkujve.

4.5. Indeksi i barazisë gjinore në aspektin e shkollimit të mesëm të lartë është relativisht i mire, ku numri i nxënësve të regjistruar është pak a shumë i njëjtë mes femrave dhe meshkujve. I njëjti fenomen vërehet edhe tek regjistrimet në nivelin e mesëm të ulët, përkatësisht në klasën e 6.

4.C. I numri i mësimdhënësve në raport me numrin e nxënësve janë zvogëluar nga viti akademik 2020/2021.

### Situata e përgjithshme

Sistemi arsimor në Kosovë ndahet në nivele të arsimit parafillor, fillor, të mesëm dhe të lartë. Arsimit parafillor është fakultativ, ndërsa arsimi fillor është i detyrueshëm dhe zgjat nëntë vjet. Arsimit të mesëm ofron pista të përgjithshme dhe profesionale, secila prej tre vjetësh. Institucionet e arsimit të lartë, përfshirë universitetet private dhe publike, ofrojnë programe universitare dhe pasuniversitare. Kosova thekson aftësimin profesional për t'i pajisur studentët me aftësi praktike. Janë bërë përpjekje për të harmonizuar sistemin me standardet ndërkombëtare, megjithëse sfidat vazhdojnë, si nevoja për zhvillimin e infrastrukturës dhe trajnimin e mësuesve. Gjithëpërfshirja dhe qasja e barabartë në arsim, duke përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta, janë pikat kryesore të politikave arsimore të Kosovës.

Pjesëmarrja në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në vitin shkollor 2022/23 është më e ulët për 1.71%, krahasuar me vitin paraprak[6]. Gjithashtu pjesëmarrja e fëmijëve që mbesin jashtë arsimit fillor dhe të mesëm të ulët ishte më e ulët gjatë vitit akademik 2022/2023 se sa gjatë vitit paraprak.

Në aspektin e barazisë gjinore në punësim në arsim, Kosova qëndron mjaft mirë, ku përqindja e mësimdhënësve femra në nivelin parashkollor dhe parafillor është gati 100%, në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët ishte 59%, në nivelin e mesëm të lartë ishte 44% [7].

Në Strategjinë e Arsimit 2022 – 2026 ka 5 objektiva strategjike, të përcaktuara për 5 fushat prioritare[8]:

- **Objektiva 1:** Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme
- **Objektiva 2:** Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore
- **Objektiva 3:** Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimin gjatë gjithë jetës;
- **Objektiva 4:** Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë;
- **Objektiva 5:** Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital

Vizioni i kësaj strategjie është **“Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, që zhvillon potencialin dhe kompetencat e individëve, si dhe inkurajon mësimin gjatë gjithë jetës, në përputhje me trendet e transformimit global”** dhe lidhet me SKZH 2030.

[7] Agjencia e Statistikave të Kosovës. Kosova në shifra 2022. E qasshme këtu: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/8bb60bb7-a9ee-469b-a759-9bc84a7b46ae.pdf>

[8] Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Strategjia e Arsimit 2022-2026. E qasshme këtu <https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/03-Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Alb-Web.pdf>

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji mbi  
Edukimin  
Parashkollor

Ligji për Arsimin  
Parauniversitar

Ligji për Arsimin  
në Komuna

Ligji për Arsimin  
dhe Aftësimin  
Profesional

Ligji për Arsimin  
dhe Aftësimin  
për të Rritur

Ligji për Arsimin e  
Lartë

Ligji për  
Inspektoratin e  
Arsimit

Ligji për  
Inovacion  
Shkencor dhe  
Transfer të Dijes  
dhe Teknologjisë


Ligji për  
Kualifikime  
Kombëtare

Ligji për  
veprimtaritë  
kërkimore –  
shkencore

Ligji për  
Kualifikimet

## Sfidat kryesore

- Qasja në arsim cilësor: Ekzistojnë dallime në cilësinë e arsimit ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe ndërmjet rajoneve të ndryshme brenda Kosovës. Zonat urbane priren të kenë resurse më të mira, duke përfshirë staf arsimor më të kualifikuar, ndërsa zonat rurale u përballën me vështirësi në tërheqjen dhe mbajtjen e stafit të kualifikuar.
- Numri i nxënësve në zonat urbane dhe rurale. Në këto të fundit numri i nxënësve është vazhdimisht duke u zvogëluar dhe kostoja e mirëmbajtjes së shkollave në ato zona është mjaft e lartë në krahasim me numrin e nxënësve.
- Mungesat dhe cilësia e mësimdhënësve: Kosova është duke u përballur me mungesë të mësuesve të kualifikuar dhe të trajnuar, veçanërisht në lëndët e specializuara. Përveç kësaj, ekziston nevoja për zhvillim të vazhdueshëm profesional për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.
- Arsimi i lartë: Ndërsa ka pasur rritje në institucionet e arsimit të lartë, çështjet si akreditimi dhe cilësia dhe zbatueshmëria e programeve të ofruara ngrenë pikëpyetje.



## OZHQ 5: : BARAZI GJINORE

Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave

### Vlerësimi i targeteve

5.1 Mund të themi se Kosova ka një bazë ligjore të kënaqëshme për të promovuar barazinë gjinore. Përveç Kushtetutës, që garanton të drejta dhe liri të barabarta për të gjithë qytetarët, pa dallim gjinie apo gjinie, Kosova gjithashtu ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave dhe ka adoptuar Deklaratën e Pekinit dhe Platforma për Veprim. Të gjitha këto legjislacione, bashkë me Ligjin për Barazi Gjinore, shërbejnë si bazë për veprimet e Agjencisë për Barazi Gjinore në kuadër të ZK. Por, pavarësisht ekzistimit të kornizës ligjore, arritja e barazisë gjinore në Kosovë përballet me shumë sfida të cilat e pamundësojnë që ti japim fund të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe vajzave.

5.2 Gjatë periudhës 2019 – 2022 numri i rasteve të sulmeve seksuale raportuara në Policinë e Kosovës ishte 257[9]. Kurse numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje gjatë vitit 2022 ishte 2764, ku prej tyre 2294 ishin të gjinisë femrore dhe 523 të gjinisë mashkullore[10]. Kjo është shumë shqetësuese sepse kemi një rritje prej 13.65% të rasteve të raportuara nga viti paraprak.

5.3 Gjatë vitit 2022 kishte 768 raste të kurorëzimeve ku gruaja ishte 15 – 19 vjet, ndërsa 88 raste ku burri ishte 15-19 vjet.

5.5 Gratë akoma mbeten të nënpërfaqësuar në parlament, me vetëm 32.5% të ulëseve.

5.6 Përveç Ligjit për Shëndetin Riprodhues, tani së fundimi Kuvendi i Kosovës ka miratuar në parim Ligjin për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor. Me këto dy ligje parimisht garantohen të drejtat për qasje universale në shëndetin riprodhues dhe të drejtat për informim në shëndetin seksual.

[9] QIKA, Rastet e sulmeve seksuale të raportuara në Policinë e Kosovës (2019-2022). E qasshme këtu: <https://data.qika.org/infografike/policia-e-kosoves/rastet-e-sulmeve-seksuale-te-raportuara-ne-policine-e-kosoves-2019-2022/>

[10] QIKA, Rastet e dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës – 2022. E qasshme këtu: <https://data.qika.org/infografike/policia-e-kosoves/rastet-e-dhunes-ne-familje-te-raportuara-ne-policine-e-kosoves-2022/>

## Situata e përgjithshme

Pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme drejt progresit, normat e vazhdueshme socio-kulturore dhe pabarazitë ekonomike vazhdojnë të pengojnë realizimin e plotë të barazisë gjinore në Kosovë. Siç u cek edhe më lartë, sa i përket kornizës ligjore dhe politike, Kosova ka ndërmarrë hapa të lavdërueshëm drejt promovimit të barazisë gjinore. Kushtetuta e vendit garanton të drejta të barabarta për burrat dhe gratë, dhe ligje të shumta janë miratuar për të mbrojtur dhe avancuar të drejtat e grave. Ligji për Barazinë Gjinore, i krijuar në vitin 2004, shërben si një mjet themelor legjislativ në këtë drejtim. Megjithatë, ndërsa këto instrumente ligjore dhe politikash ofrojnë një bazë solide, zbatimi i tyre mbetet sfida kryesore. Gratë në Kosovë ende përballen me pengesa thelbësore në qasjen në drejtësi dhe rastet e dhunës në familje vazhdojnë të mos raportohen të gjitha. Për më tepër, rolet dhe stereotipet tradicionale gjinore vazhdojnë si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, duke ndikuar në mundësitë e grave për arsimim dhe fuqizim ekonomik. Kjo është veçanërisht e dukshme në tregun e punës, ku gratë shpesh kufizohen në punë me pagë të ulët dhe joformale, ndërsa përfaqësimi në pozita udhëheqëse mbetet në mënyrë disproporcionale të ulët. Shkalla e punësimit të gjinisë femrore në raport me popullsinë gjatë vitit 2022 ishte 18.4%. Numri më i madh i femrave të punësuar është në sektorin e Arsimit (24,565 të punësuar), e pasuar nga Tregtia me shumicë dhe pakicë (21,156 të punësuar) dhe Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social (9,247 të punësuar). Pra njëjtë sikur vitetet e kaluara, femrat janë të punësuar kryesisht në aktivitete të ekonomisë terciare

Në anën tjetër arsimit qëndron si një arenë jetike në arritjen e barazisë gjinore. Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në promovimin e arsimimit të vajzave, me rritjen e shkallës së regjistrimit në nivelet fillore dhe të mesme. Megjithatë, pabarazitë vazhdojnë, veçanërisht në komunitetet rurale dhe të marginalizuara. Faktorë të tillë si martesat e hershme dhe akseset e kufizuara në arsim cilësor pengojnë përparimin. Përpjekjet për të luftuar këto çështje përfshijnë fushata ndërgjegjësimi dhe programe bursash të synuara për vajzat, siç janë bursat STEM që i ofron MASHT, që synojnë të thyejnë ciklin e përjashtimit arsimor.

Të drejtat e barabarta në qasjen në arsim duhet të pasohen nga përfshirja e grave në pozita vendimmarrëse. Edhe pse gjatë viteve të fundit kemi pasur përmirësime, numri i grave në pozita vendimmarrëse është ende i vogël. Arsyeet pse gratë nuk aplikojnë në këto pozita, ka të bëjë me stereotipet gjinore, perceptimin e grave se burrat janë udhëheqës me të përshtatshëm, obligimet që gratë kanë në familje, dhe mungesën e një strategjie institucionale për motivimin e tyre

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji për Barazi  
Gjinore

Ligji për  
Mbrojtjen nga  
Diskriminimi

Koncept  
Dokumenti për  
Buxhetimin e  
Përgjegjshëm  
Gjinor

Strategjia  
Kombëtare për  
Mbrojtje nga  
Dhuna në Familje  
dhe Dhuna ndaj  
Grave 2022-2026

Kodi Penal

Ligji për  
Shëndetin  
Riprodhues

Ligji për  
parandalimin dhe  
mbrojtjen nga  
dhuna në familje,  
dhuna ndaj grave  
dhe dhuna në  
baza gjinore



## Sfidat kryesore

- Normat tradicionale shoqërore dhe stereotipet gjinore të rrënjosura thellë vazhdojnë të jenë të pranishme në Kosovë. Këto norma shpesh diktojnë role dhe pritshmëri të ngurtë për burrat dhe gratë, duke kufizuar mundësitë për gratë në arsim, punësim dhe pjesëmarrje politike.
- Gratë në Kosovë përjetojnë një hendek të madh gjinor në paga dhe janë të përfaqësuara në mënyrë disproporcionale në sektorët e punësimit me pagë të ulët dhe joformal. Qasja në kredi dhe burime financiare për gratë sipërmarrëse është gjithashtu e kufizuar, gjë që pengon aftësinë e tyre për të filluar dhe rritur biznese.
- Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuara në pozita udhëheqëse në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë politikën, biznesin dhe shoqërinë civile. Kjo mungesë përfaqësimi përforcon pabarazitë gjinore në proceset vendimmarrëse.
- Pavarësisht që kuota gjinore prej 30% është në fuqi, gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuara në organet vendimmarrëse politike. Balancimi i karrierës politike me përgjegjësitë familjare, si dhe normat kulturore mbizotëruese, mund t'i dekurajojë gratë nga pjesëmarrja aktive në politikë.
- Gratë në Kosovë shpesh përballen me sfida në qasjen në drejtësi, veçanërisht në rastet e dhunës në familje ose diskriminimit në baza gjinore. Kjo mund të jetë për shkak të mungesës së informimit për të drejtat e tyre ligjore, kufizimeve financiare ose frikës nga hakmarrja.



## OZHQ 6: UJË I PASTËR DHE KANALIZIME

Sigurimi i qasjes në furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë

### Vlerësimi i targeteve

6.1 Sipas vlerësimeve, sistemet qendrore që furnizohen nga shtatë biznese sigurojnë ujë të pijshëm për rreth 79% të popullsisë së Kosovës [11]. Sipas kësaj, nga gjithsej 1,240 janë vetëm 672 vend-banime që kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU

### Situata e përgjithshme

Një nga të drejtat thelbësore të njeriut dhe kërkesa thelbësore strategjike për zhvillimin social dhe ekonomik të një rajoni është disponueshmëria e ujit të pijshëm të pastër. Parakushti themelor për furnizimin me ujë të pastërt është monitorimi në lidhje me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e ujërave. Të dyja këto, sidomos shfrytëzimi, lidhet me faktorin njeri. Me rritjen e popullsisë është rritur edhe konsumi i ujit, ku ka mosbalancim mes kërkesës dhe furnizimit me ujë të pijshëm. Ky problem është i dukshëm veçanërisht në zonat e mbipopulluara urbane, ku sistemi i shpërndarjes së ujit të pijshëm nuk është mjaftueshëm efikas dhe prandaj shumë zona nuk kanë ujë të pijshëm 24/7. Problem të ngjashëm kanë edhe zonat rurale, por një progress i lehtë është parë me shtimin e 6 sistemeve rurale të ujësjellësit nën menaxhimin e KRU.

Një tjetër faktorë që i shtohet problemit është edhe ndotja e resurseve ujore. Fatkeqësisht Kosova nuk ka mekanizma të mjaftueshëm për mbrojtje adekuate të ujërave dhe kontrollim të ndotjes. Këtu kontribuojnë aktivitete të caktuara industriale, përdorimi i plehrave dhe pesticideve dhe infrastruktura e vjetëruar ose e mirëmbajtur keq.

[11] Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, Niveli i shërbimeve të ofruara nga Ofruesit e licencuar. E qasshme këtu:

[https://www.arrurks.org/assets/cms/uploads/files/Inspektimi/Raportet/Raporti%20per%20Nivelin%20e%20Sherbimeve%202022%20\(1\).pdf](https://www.arrurks.org/assets/cms/uploads/files/Inspektimi/Raportet/Raporti%20per%20Nivelin%20e%20Sherbimeve%202022%20(1).pdf)

Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit nënkupton përdorimin e ujit në një mënyrë që plotëson nevojat aktuale, ekologjike, sociale dhe ekonomike pa kompromentuar aftësinë për të përmbushur këto nevoja në të ardhmen [12]. Disa nga parimet kryesore të menaxhimit të qëndrueshëm të ujit përfshijnë: balancimi i nevojave dhe furnizimit, mbrojtja e cilësisë së ujit, ruajtja dhe efikasiteti, përshtatshmëria ndaj ndryshimeve klimatike, integrimi me planifikimin infrastrukturor, etj.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji për  
ujërat e  
Kosovës

Ligji për  
rregullimin e  
Shërbimeve  
të ujit


Rregulloret e  
Autoritetit

## Sfidat kryesore

- Mos-posedimi i lejeve ujore për rreth 58% të burimeve që janë në shfrytëzim nga KRU dhe mos definimi i obligimeve të ndërsjellta rreth përgjegjësisë për mirëmbajtjen e burimeve që shfrytëzohen për konsum njerëzor [13]
- Ujërat e ndotura vazhdojnë të derdhen në rreth 25 trupa ujqorë për shkak se ujërat e ndotura nuk po kontrollohen siç duhet. Deri më tani, në mbarë Kosovën, janë në funksion vetëm 8 impiante (prej tyre 7 sisteme relativisht të vogla) të trajtimit të ujërave të ndotura.
- Regjione të caktuara brenda Kosovës kanë mungesë uji dhe mund të ketë pabarazi në qasjen në burimet ujore ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Shpërndarja e pabarabartë mund të çojë në tensione sociale, konflikte dhe pabarazi ekonomike. Ai gjithashtu mund të përkeqësojë degradimin e mjedisit pasi komunitetet mund të përdorin praktika të paqëndrueshme për të siguruar ujin.

[13] Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, Niveli i shërbimeve të ofruara nga Ofruesit e licencuar. E qasshme këtu:

[https://www.arrurks.org/assets/cms/uploads/files/Inspektimi/Raportet/Raporti%20per%20Nivelin%20e%20Sherbimeve%202022%20\(1\).pdf](https://www.arrurks.org/assets/cms/uploads/files/Inspektimi/Raportet/Raporti%20per%20Nivelin%20e%20Sherbimeve%202022%20(1).pdf)



## OZHQ 7: ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËRT

Sigurimi i furnizimit me energji me kosto të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme, dhe moderne për të gjithë

### Vlerësimi i targeteve

7.1 Kosova vazhdon të ketë mbulueshmëri 100% të popullsisë me energji elektrike.

7.2 Prodhimi i BRE-ve të kyçura në rrjetin e transmetimit në vitin 2022 ka qenë 469.4 GWh dhe është më i lartë për 57.8 % krahasuar me vitin 2021, për shkak të operimit me kapacitet te plotë prej 103.41 MW të centralit me erë Sowi[14]. Kjo do të thotë se ka trend të rritjes së pjesëmarrjes së energjisë së ripërtishme në përqindjen e përgjithshme të burimeve të energjisë.


7.b Kapaciteti total i instaluar për gjenerim të energjisë së ripërtrishme për vitin 2022 ishte 202.96 MW.

### Situata e përgjithshme

Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë vazhdon të bazohet në linjit si lëndë të parë. Kapacitetet të instaluara prodhuese janë prej 1,568 MW, përfshirë edhe kapacitetet gjeneruese nga BRE, ku kapaciteti operativ konsiderohet rreth 1,236 MW, prej të cilave termocentralet (TC) me linjit përbëjnë rreth 77.69 %, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga HC Ujmani, BRE në transmetim dhe BRE tjera (hidrocentralet, panelet solare dhe centralet me erë) me 22.31 %.[15] Përgjegjësia më e madhe për prodhimin e energjisë elektrike bie mbi termocentralin Kosova B, i cili gjatë vitit 2022 ka prodhuar afër 6000 GWh.

[14] Zyra e Rregullatorit për Energji, Raporti Vjetor 2022. E qasshme këtu: [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202022\\_ZRRE.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202022_ZRRE.pdf)

[15] Po e njejta



Balancimi i nevojave për energji elektrike dhe kapaciteteve prodhuese është një problem i cili e ka percjellur Kosovën ndër vite, sidomos gjatë kohës së sezonës dimërore. Shpesh herë ka qenë e nevojshme importi i energjisë nga vendet e tjera për plotësimin e nevojave të qytetarëve. Pjesëmarrja e importit ndaj kërkesës së gjithmbarshme për energji ka qenë 11.63%, duke shënuar rënie për rreth 7.41% në raport me vitin e kaluar. Pjesëmarrja e konsumatorëve familjarë në konsumin e përgjithshëm të faturuar edhe më tutje mbetet dominues me rreth 63.27 %, e pasuar nga konsumi komercial me 23.59%, e pastaj nga konsumi industrial me 12.38 %, dhe në fund nga konsumi në ndriçimin publik me 0.76 %.

Kosova është anëtare e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe njëra nga obligimet ishte që deri në vitin 2020, 25% e burimeve të energjisë të jenë nga BRE, por fatkeqesisht ky obligim nuk është përmbushur, edhe pse Kosova iu afrua shumë me 24.4%. I vetmi progres i dallueshëm në këtë drejtim është Ligji për Burime të Ripërtrishme, që ka kaluar në fazën e parë të leximit. Kosova është në fazat e hershme të transpozimit të Paketës së Energjisë së Pastër 2021, me përjashtim të legjislacionit për energjinë elektrike ku ende nuk ka filluar hartimi [16].

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2031 dhe Projektligji për Burimet e Ripërtitshme

Ligji për Energjinë

Ligji për Efiçencë të Energjisë

Ligji për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për projektin "Efiçienca e energjisë në ndërtesa publike në Prizren" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Ligji për Energjinë Elektrike

Ligji për Energjinë Termike

Ligji Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për projektin "Korniza E Qyteteve Të Gjelbërta 2 Dritarja 2- Efiçienca E Energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë "ndërmjet Republikës Së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

## Sfidat kryesore

- Vjetërsia e termocentraleve ekzistuese me qymyr, Kosova A dhe B, nevoja për përmirësime ose zëvendësime të konsiderueshme, paraqet problem në çështjet e efikasitetit të energjisë.
- Teknologjia ekzistuese e kapaciteteve gjeneruese nuk i plotëson kriteret mjedisore për operim, dhe si pasojë kemi edhe mungesë të investimeve nga investitorët e huaj
- Sigurimi i fondeve për modernizimin apo ndërtimin e infrastrukturës së re energjetike, veçanërisht për projektet e burimeve të rinovueshme, vazhdon të jetë mjaft sfiduese për Kosovën.
- Sfida kryesore për vitet e ardhshme mbetet kalimi nga energjia e prodhuar me lëndë "tradicionale" bazë si qymyri, në energji të ripërtishme. Për ta bërë këtë tranzicion nevojitet krijimi i mekanizmave gjenerues adekuat që mund t'i përballojnë kërkesat e konsumatorëve për energji.





## OZHQ 8: PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE

Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë

### Vlerësimi i targeteve

8.1 PBB-ja e Kosovës për kokë banori për vitin 2022 ishte rreth 5066€, një rritje prej 1.55% nga viti 2021.

8.5 Shkalla e papunësisë gjatë vitit 2022 ishte rreth 12.6%, ku me papunësinë më e lartë ishte grupmosha 15-24, me 21.4% nivel të papunësisë. Në këtë grupëmoshë, niveli i papunësisë tek femrat ishte 16.5% kurse tek meshkujt 11%

8.6 Të dhënat nga ASK e tregojnë vetëm numrin e të rinjëve që janë përfshirë në punësim, arsimim apo trajnime profesionale, por duke e parë që ky numër është në rënie atëherë mund të supozojmë se fatkeqësisht numri i të rinjëve që nuk janë të përfshirë në punësim, arsimim apo trajnime profesionale po rritet. Ky fenomen mund të ketë shumë arsye mbrapa, njëra prej tyre mund të jetë punësimi i të rinjëve në sektorin informal të ekonomisë e për të cilin fatkeqësisht nuk kemi të dhëna.

8.7 Nuk kemi të dhëna zyrtare sa i përket numrit të fëmijëve që punojnë çfarëdo sektori të ekonomisë, por sipas Departamentit Amerikan të Punës, në vitin 2022, Kosova ka bërë përpjekje të moderuar në përpjekjet për të eliminuar format më të rënda të punës së fëmijëve.

8.8 Siguria në vendin e punës është ende një problem për punëtorët kosovarë. Gjatë vitit 2021, Inspektorati i Punës ka regjistruar 188 aksidente në vendin e punës, prej të cilave 139 kanë rezultuar me lëndime të lehta, 40 prej tyre kanë rezultuar me lëndime më të rënda dhe 9 prej tyre me fatalitet në vendin e punës [17]

## Situata e përgjithsme

Të dhënat nga ASK tregojnë se PBB e Kosovës në vitin 2022 kishte pasur rritje prej 3.5%. E matur me çmimet aktuale, PBB-ja e Kosovës arriti në 9 miliardë euro (9.5 miliardë dollarë) në vitin 2022, pasi arriti në 8 miliardë euro në vitin paraprak. Sektorët me kontributin më të madh pozitiv në rritjen ekonomike të Kosovës në vitin 2022 ishin tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimet e automjeteve dhe motoçikletave me 10.8%, informimi dhe komunikimi me 9.2%, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 7% dhe aktivitetet administrative dhe mbështetëse me 6.7%.

Sipas ASK-së, shkalla e punësimit për vitin 2022 ishte 33.8%. Ka një dallim të madh mes shkallës së punësimit të meshkujt, me 49.4%, dhe të femrat, me 18.4%. Shkalla e popullsisë ekonomike jo aktive si pjesë e popullsisë në moshë pune është mjaft e lartë, me 61.4%. Ky numër mund të mos e paraqet realitetin plotësisht sepse në llogaritje nuk hyn punësimi joformal. Gjithashtu shqetësuese është edhe shkalla e papunësisë tek të rinjtë, që ishte 21.4% në vitin 2022. Përsëri përqindja e femrave në këtë grup është më e lartë se ajo e meshkujve.

Numri total i të punësuarëve me kontrata gjatë vitit 2022 ishte 50,702, ku prej tyre 32,492 ishin meshkuj. Gjithashtu edhe numri më i madh i të punësuarëve pa kontrata ishin meshkuj [18]

Paga mesatare bruto shënoi një rritje gati të papërfillshme, nga 484€ sa ishte në vitin 2021, në 521€ në vitin 2022, por prap Kosova mbetet njëra nga dy vendet me pagat më të ulëta në regjionin e Ballkanit. Paga mesatare bruto në sektorin privat në vitin 2022 ishte 473 euro, ndërsa në vitin 2021 ishte 419 euro. Sipas ASK-së, paga mesatare bruto në vitin 2022, sipas aktiviteteve ekonomike, ishte më e larta në: Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (968 euro) dhe informim dhe komunikim (896 euro). Deri atëherë, paga më e ulët ishte në aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (323 euro) [19]

Skema e ndihmës sociale përbënë një rën nga aspektet kryesore të mirëqenies në Kosovë. Sipas të dhënave nga ASK, numri i familjeve që kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale gjatë vitit 2022 ishte 22 980, ku numri më i madh i këtyre familjeve ishte nga regjioni i Mitrovicës, e pasuar nga Prishtina dhe Peja.

[18] Inspektorati i Punës, Raporti i Punës për vitin 2022. E qasshme këtu: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/Raporti-Vjetor-2022-IP.pdf>

[19] Kosova Press, "Average wages 521 euros in Kosovo, only 37 euros increase in 2022". E qasshme këtu: <https://kosovapress.com/en/pagat-mesatare-521-euro-ne-kosove-nje-rritje-prej-37-eurosh-me-2022/>

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji i Punës

Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme

Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti

Ligji për Agjencinë e Punësimit

Ligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve për të papunët, punëkërkuarit dhe punëdhënësit

Ligji për ratifikimin e marrëveshjes së financimit në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës Dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për "Projektin e Reformës së Sistemit të Ndihmës Sociale në Kosovë"

Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë

Ligji për kompensimin e viktimave të krimit

## Sfidat kryesore

- Kosova ka një nga normat më të larta të papunësisë së të rinjve në Evropë. Kjo është një sfidë e madhe sociale dhe ekonomike, pasi çon në mungesë mundësish për të rinjtë, duke rezultuar potencialisht në trazira sociale dhe emigracion.
- Shpesh ka një shkëputje midis aftësive të mësuara në institucionet arsimore dhe atyre të kërkuara nga tregu i punës, gjë që mund të çojë në papunësi ose nëpunësim. Një trend që është vazhdimisht në rritje viteve të fundit është emigrimi i të rinjve në fusha profesionale, drejt vendeve, kryesisht gjermano – folëse, të BE-së.
- Përderisa remitancat paraqesin një burim të konsiderueshëm të të ardhurave, varësia nga burimet e jashtme të të ardhurave mund ta bëjë ekonominë të ndjeshme ndaj luhatjeve në ekonominë globale dhe ndryshimeve në situatën ekonomike të diasporës.
- Paqëndrueshmëria politike mund të pengoj investimet e huaja direkte (IHD) dhe të pengoj rritjen e bizneseve vendase, pasi investitorët mund ta perceptojnë mjedisin si të rrezikshëm dhe të pasigurt.
- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) shpesh luftojnë për të marrë financim, gjë që kufizon aftësinë e tyre për të investuar, rritur dhe krijuar vende pune.



## OZHQ 9: INDUSTRI, INOVACION DHE INFRASTRUKTURË

Ndërtimi i një infrastrukture rezistuese, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe promovimi i inovacionit

### Vlerësimi i targeteve

9.1 Numri i pasagjerëve të transportit hakurudhor ishte 73 mijë në vitin 2022, në krahasim me 60 mijë në vitin 2021.

9.2 Industria përpunuese në Kosovë paraqet 13.2 % të BPV-së.

### Situata e përgjithshme

Prodhimi si aktivitet ekonomik ka një përqindje shumë të vogël të numrit të punësuarve në raport me aktivitetet e tjera. Në vitin 2022 përqindja e të punësuarëve në prodhim ishte vetëm 8.9%.

Siç u përmend më lartë, paqëndrueshmëria ekonomike dhe politike e Kosovës shpesh herë ndikon që të largojë investitorët e huaj. Por, gjatë vitit 2022, në kuadër të llogarisë financiare, investimet e huaja direkte shënuan rritje vjetore prej 85.0% dhe arritën vlerën prej 778.2 milionë euro[20]. Sektori i patundshmërisë përbën 67.3% të gjithsej IHD-ve, ndërkohë që vlera e remitencave të pranuar në vitin 2022 ka arritur në 1.22 miliard euro. 3 vendet që kanë investuar më së shumti në Kosovë gjatë vitit 2022 janë: Gjermania, Zvicra dhe Turqia.

Në vitin 2022 numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte 11 024, ku numri më i madh i tyre ishte në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave, i pasuar nga ndërtimtaria dhe prodhimi. Gjithashtu numri më i madh i të punësuarve (19.3%) është në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave. Gjatë vitit 2022 kishte edhe ndërmarrje që u shuan, rreth 1784 sosh. Në Kosovë gjatë vitit 2022 kryesisht u regjistruan mikro ndërmarrje, që përbëjnë 98,9% të ndërmarrjeve, ndërsa nuk u regjistrua asnjë ndërmarrje të madhe.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji për  
inovacion  
shkencor dhe  
transfer të dijes  
dhe teknologjisë


Ligji për dizajnin  
industrial

Ligji për  
hekurudhat  
e Kosovës

Ligji për krijimin e  
Infrastrukturës  
Kombëtare të  
Informacionit  
Hapësinor në  
Republikën e  
Kosovës

## Sfidat kryesore

- Furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike e detyron Kosovën të importojë energji nga vendet e tjera, dhe rrjedhimisht të vështirësojë përballimin e kosotos së energjisë për qytetarët dhe ndërmarrjet/bizneset.
- Kosova ka 2384.3km rrugë të asfaltuara dhe 49.7km rrugë të paasfaltuara. Disa rrugë janë në gjendje të jo të mirë dhe ka kufizime sa i përket lidhjes rrugore ndërmjet rajoneve.
- Përveç në kryeqytet, transporti publik në komunat e tjera nuk është mjaftueshëm i zhvilluar. Kjo mund të jetë një pengesë për zhvillimin ekonomik dhe lëvizshmërinë e qytetarëve por edhe turizatave nga vendet e huaja.
- Është jetike të arrihet një ekuilibër midis nevojës për zgjerimin e infrastrukturës dhe shqetësimeve mjedisore. Kjo përfshin marrjen parasysh të mënyrës se si përdoret toka, furnizimet me ujë të disponueshëm dhe cilësia e ajrit. Për shkak të këtyre faktorëve, është thelbësore të vlerësohet dhe të konsolidohet informacioni në lidhje me lejet mjedisore të dhëna për biznese të caktuara. Gjithashtu është e rëndësishme të bëhen përpjekje në fushat si infrastruktura intelegjente dhe transporti miqsor ndaj ambientit.
- Pozita e Kosovës pa dalje në det e bën atë të varur nga vendet fqinje për qasje në tregjet ndërkombëtare. Sigurimi i lidhjeve të qetë të transportit me vendet fqinje është thelbësor për rritjen ekonomike.



## OZHQ 10: ZVOGËLIM I PABARAZIVE

Ulja e pabarazive përbrenda dhe ndërmjet vendeve

### Vlerësimi i targeteve

10.4 sipas buxhetit të vitit 2023, pagat dhe mëditjet përbëjnë 18.09% të vlerës totale të BPV-së.

10.5 Treguesit financiar në Kosovë publikohen në baza vjetore nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Në vitin 2022: Kthimi i aseteve (2.57%); Asetet e kapitalit rregullator (8.91%); Asetet likuide ndaj detyrimeve afatshkurta (36.52%); Kreditë me probleme ndaj totalit të kredive bruto (1.94%); Pozicioni i hapur neto në kapitalin valutor (3.32%), Asetet e kapitalit rregullator të nivelit 1 të ponderuara (12.82%)


10.a Lirimi nga taksa doganore bëhet për: pajisje bujqësore, mallërat e ndërtimtarisë që vijnë nga vendet e CEFTA-s, disa produkte farmaceutike, avionët civil dhe mallrat për përdorim në aviacionin civil. Vendet që janë jashtë CEFTA-s dhe produktet e tjera që nuk janë të përfshira në dispozitat e veçanta të tarifave doganore të Kosovës, paguajnë obligimet e plota (10% taksë doganore dhe 18% TVSH)

10.b Vlera e remitencave të pranuar në vitin 2022 ka arritur në 1.22 miliard euro.

### Situata e përgjithshme

Kosova konsiderohet si një nga vendet më të varfra në Evropë, me një GDP relativisht të ulët për kokë banori. Pabarazia ekonomike është një çështje e dukshme, me një hendek në rritje midis segmenteve më të pasura dhe më të varfra të popullsisë. Ky hendek është zmadhuar akoma më shumë në periudhën pas pandemisë dhe pas luftës në Ukrainë, kur rritja e çmimeve bëri që shumë familje të hasin në vështirësi për ta përballuar shportën ushqimore bazike të konsumit.





Inflacioni (indeksi i çmimeve të konsumit) për vitin 2022 ishte 11.6%. Do të thotë se inflacioni u rrit më shumë 3 herë, krahasuar me vitin 2021 kur inflacioni ishte 3.4%. Paga mesatare neto gjatë vitit 2022 ishte 521€.

Faktorët kryesor që ndikojnë në rritjen pabarazisë ekonomike janë papunësia, puna jo-formale, puna me pagë të ulët, etj. Gjithashtu ekzistojnë edhe pabarazi të formave të tjera si gjinore, aftësisë trupore, etnike etj. Kjo e fundit është evidente veçanërisht tek komuniteti romë, të cilët kanë më shumë gjasa të jenë të punësuar në sektorin jo-formal ose të jenë të papunë. Pabarazi dhe diskriminime ka edhe ndaj personave me aftësi të kufizuara, duke filluar nga vështirësia e qasjes në komunikacion dhe objekte publike, deri te qasja në tregun e punës.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi

Ligji për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti

Ligji për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës

Ligji për mbrojtjen e fëmijës

## Sfidat kryesore

- Qasja në arsim cilësor dhe shërbime të kujdesit shëndetësor vazhdon të jetë e kufizuar, veçanërisht në zonat rurale. Kjo pengon lëvizshmërinë sociale dhe thellon pabarazitë.
- Një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit ekonomik operon në sektorin informal. Kjo çon në paga më të ulëta, më pak siguri në punë dhe më pak mbrojtje ligjore për punëtorët.
- Shpërndarja e pronave dhe ndarja e pasurisë kanë implikime në diskriminimin në baza gjinore. Edhe pse ligji në Kosovë ia u njeh të drejtën grave për trashëgimi pronësore, zbatimi i ligjeve të tilla në praktikë lë shumë për të dëshiruar.



## OZHQ 11: QYTETE DHE KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

Bërja e qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, të forta e të qëndrueshme

### Vlerësimi i targeteve

11.7.2 Gjatë periudhës 2019 – 2022 numri i rasteve të sulmeve seksuale raportuara në Policinë e Kosovës ishte 257

### Situata e përgjithshme

Që nga fundi i shekullit të 20-të, Kosova i është nënshtruar një procesi të shpejtë urbanizimi, veçanërisht pas vitit 2000. Kryeqyteti, Prishtina, u shfaq si pikë qendrore e kësaj rritjeje urbane, duke u bërë qendra politike, kulturore dhe ekonomike e vendit. Në këtë intensitet të lartë të urbanizimit, veçanërisht në Prishtinë, ka ndikuar rritja e shpejtë e popullsisë, migrimet nga fshati në qytet, ndryshimet në tregun e punës, etj.

Edhe pse nuk kemi të dhëna zyrtare për shkallën e urbanizimit, me një vështrim në jetën reale mund ta vërejmë se në zonat rurale nuk ka shumë popullsi të re si pasojë e lëvizjes së kësaj grupmoshe drejt qyteteve. Kjo ka bërë që shumë qytete të jenë të mbipopulluara dhe të ngarkuara me banesa/ndërtesa të cilat kontribuojnë degradim të vazhdueshëm të mjedisit. Njëra ndër arsyet se pse popullsia e re është vazhdimisht duke migruar drejt qytetve ka të bëjë edhe me mungesën e transportit dhe infrastrukturës adekuate që lidh zonat rurale me qytetet. Tregu i punës dhe mundësitë ekonomike janë më të mira në qytete, duke e shfaqur kështu nevojën për të udhëtuar drejt qyteteve. Mungesa e transportit adekuat dhe infrastrukturës efikase e vështirëson shumë aspektin e udhëtimit nga vendbanimi deri në vendin e punës, në raste kur vendbanimi është në zona rurale dhe puna në zonat urbane. Në mungesë të kësaj qytetarët “detyrohen” të migrojnë drejt qyteteve për të pasur qasje më të lehtë në transport.

Në vitin 2022, nga 2434km rrugë, 2384.3km kanë qenë të asfaltuara dhe 49.7km të paasfaltuara. Sa i përket transportit hekurudhor, ky shfrytëzohet shumë pak nga qytetarët për shkak të vjetërsisë së tij dhe lidhjeve jo të mira hekurudhore mes qyteteve. Gjatë vitit 2022 transportin hekurudhor e kanë shfrytëzuar vetëm 73 mijë pasagjerë

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji për  
transportin  
rrugor

Ligji për  
trashëgimin  
kulturore

Ligji për zonat  
e veçanta të  
mbrojtura

Ligji i ndërtimit

Ligji për liritë  
fetare

Ligji për  
mbrojtjen e  
mjedisit

Ligji për zhvillim  
rajonal të  
balancuar

Ligji për bujqësi  
dhe zhvillim  
rural

Ligji për  
vlerësimin e  
ndikimit në  
mjedis

Strategjia e  
Transportit  
Multimodal  
2023 – 2030

## Sfidat kryesore

- Ofrimi më efektiv i shërbimeve në zonat rurale pengohet nga transporti dhe infrastruktura e dobët shëndetësore. Kjo është një arsye tjetër se pse qytetarët migrojnë drejtë zonave urbane
- Financimi i ulët i komunave dhe ndarjet buxhetore joadekuate të komunave për zhvillimin e fshatrave bëjnë që këto të fundit të kenë një jetë të kufizuar sociale
- Degradimi i vazhdueshëm i ambientit në zona urbane nga planifikimi i gabuar hapsinor dhe keqpërdorimi i hapsirave publike



## OZHQ 12: KONSUM DHE PRODHIM I PËRGJEGJSHËM

Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit

### Vlerësimi i targeteve

12.4 Raporte të qëndrueshmërisë për vitin 2022 ka publikuar Banka Raiffeisen

12.A Kapaciteti i instaluar për gjenerimin e energjisë së rinovueshme në Kosovë në vitin 2022 ka qenë 202.96 MW.

### Situata e përgjithshme

Sektori agrar në Kosovë ka qenë prej kohësh një shtyllë e rëndësishme e ekonomisë, duke përfshirë kulturat kryesore si gruri, misri dhe patatet, së bashku me blegtorinë. Sado që ky sektor përbënë një pjesë të konsiderueshme të PBV-së, në anën tjetër, kontribuon edhe në ndotjen e tokave. Paralelisht me sektorin e bujqësisë, industria minerare, veçanërisht nxjerrja e linjtit, është mjaft e rëndësishme sepse ka qenë dhe vazhdon të jetë një komponentë kryesor në prodhimin e energjisë.

Fatkeqësisht, mbeturinat që prodhohen nga sektori bujqësor dhe ai mineral, bashkë me mbeturinat e tjera, nuk menaxhohen në mënyrë të duhur. Tërë sistemi i menaxhimit të mbeturinave është i bazuar në një sistem shumë të ulët të riciklimit. Fatkeqësisht të dhënat për trajtimin e mbeturinave për vitin 2022 mungojnë, por gjatë vitit 2021 gjithësej mbeturina të grumbulluara ishin 483,777 tonë, ku prej të cilave 21,307 tonë ishin recikluar dhe 960 tonë ishin sterilizuar.

Për të pasur një nivel sa më të mirë të konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm, është e nevojshme që Kosova të drejtohet nga ekonomia qarkore, duke e lënë mbrapa ekonominë lineare. Meqenëse Republika e Kosovës është zotuar drejt implementimit të Agjendës 30 dhe Agjendës së Gjelbërt, tranzicioni drejt një ekonomie qarkore duhet të vazhdojë me një seriozitet më të madh se sa deri tani. Në vitin 2023 Ministria e Mjedisit, Infrastrukturës dhe Planifikimit Hapësinor ka lansuar Udhërrëfyesin për Ekonomi Qarkore, i cili do të shërbejë si pikënisje për reformat e nevojshme në të gjithë sektorë [22]

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji për  
produkte dhe  
pajisje  
medicinale

Ligji për  
blegtorinë

Ligji për  
bujqësinë  
organike

Ligji për  
ushqimin

Ligji për çmimin  
e produkteve  
medicinale

Ligji për sigurinë  
e përgjithshme  
të produkteve

Ligji për  
produktet  
biocide



## Sfidat kryesore

- Deponitë e mbeturinave nuk menaxhohen sipas standardeve dhe rregulloreve të BE-së
- Qytetarët dhe bizneset akoma nuk e kanë të qartë dhe nuk i zbatojnë praktikatat e ekonomisë qarkore për konsum të qëndrueshëm
- Nuk ka incentiva të mjaftueshme financiare apo të ndonjë forme tjetër që mund të shtyjnë bizneset drejt një zingjiri më të qëndrueshëm të konsumit dhe prodhimit
- Mungesa e legjislacionit dhe rregulloreve që i detyrojnë prodhuesit të marrin përgjegjësinë për të gjithë ciklin e jetës së produkteve të tyre, duke përfshirë grumbullimin, riciklimin ose asgjësimin e sigurt



## OZHQ 13: VEPRIMI PËR KLIMËN

Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e saj


### Vlerësimi i targeteve

13.2 Kosova së fundmi ka miratuar Ligjin për Ndryshime Klimatike dhe gjithashtu ekziston edhe Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019 – 2028. Ndërkohë që Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike ka qenë vetëm për vitet 2019 – 2021. Sa i përketë emetimeve të gazrave serrë, të dhënat e fundit që janë të qasshme janë të vitit 2021, kur emetimet vjetore të gazrave serrë kanë qenë 5.64 milionë ton.

### Situata e përgjithshme

Sektori i veprimit për klimën në Kosovë përfshinë një kontekst të gjerë të sfidave mjedisore, duke përfshirë ndotjen e ajrit, menaxhimin e mbeturinave dhe cilësinë e ujit. Në këtë aspekt vlen të përmendet mbështetja historike në lëndët fosile, si thëngjilli, brenda sektorit të energjisë, duke shkaktuar si emetimet e gazeve serrë ashtu edhe degradimin e mjedisit. Si përgjigje, qeveria ka bërë disa hapa drejt angazhimit për kalimin drejt burimeve më të pastra dhe më të qëndrueshme të energjisë. Por, duke e parë urgjencën e ngrohjes globale, hapat e ndërmarrë nga qeveria nuk janë të mjaftueshëm. Sfidat me të cilat pritet të përballë Kosova si pasojë e ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike janë pjesë e trajtimit në dokumentin Strategjia Për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028 dhe Plani i Veprimit Për Ndryshime Klimatike 2019- 2021. Për shkak të skadimit të Planit të Veprimit, kërkohet një version i ri i tij për të adresuar urgjencën e ndryshimeve klimatike në përputhje me tendencat dhe legjislacionin më të fundit për mbrojtjen e mjedisit.

Emetimet e gazrave serrë për kokë banori gjatë vitit 2021 ishin 3.4ton, që e pozicionon Kosovën në vendin e dytë, pas Serbisë, për sasinë më të madhe të emetimit të gazrave serrë në rajonin e Ballkanit Perëndimor [23]. Kosova përbënë rreth 0.02% të emetimeve në nivel global.



## Ligjet që përfshijnë këtë objektive

Ligji për mbrojtjen e mjedisit

Ligji për energjinë

Ligji për efikasitet të energjisë

Ligji për gazin natyror

Ligji për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve

Ligji për ndryshimet klimatike

Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Ligji për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për projektin "Efikasiteti dhe energjia në ndërtesa publike në Prizren" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Ligji Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për projektin "Korniza E Qyteteve Të Gjelbërta 2 Dritarja 2- Efikasiteti dhe Energjia në ndërtesa publike në Prishtinë" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

## Sfidat kryesore

- Në Kosovë akoma nuk janë miratuar politika apo ligje të veçanta kombëtare për të adresuar çështjen e ndryshimeve klimatike. Ligji për ndryshime klimatike është akoma në fazën e shqyrtimit.
- Tranzicioni i ngadalshëm nga qymyri në burime të ripërtitshme të energjisë. Sa më shumë që zgjatë ky proces as më e lartë do të jetë kostoja mjedisore. Ndërkohë që ka pasur përpjekje për të zhvilluar burime të rinovueshme të energjisë, si energjia diellore dhe e erës, kapaciteti për këto teknologji është ende relativisht i kufizuar në krahasim me kërkesën e përgjithshme për energji.
- Ndërtimet pa leje dhe mosrespektimi i standardeve të ndërtimit (p.sh. përdorimi i materialeve që shkaktojnë ndotje të lartë) është duke shkaktuar degradim të madh të mjedisit. Për më tepër shumë ndërtesa në Kosovë janë ndërtuar pa standarde të energjetisë efiçente. Riparimi dhe përmirësimi i efiçencës energjetike të ndërtesave ekzistuese është një sfidë e rëndësishme.



## OZHQ 15: JETA NË TOKË

Ndërmarrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e saj

### Vlerësimi i targeteve

15.3 Fatkeqësisht degradimi i pyjeve vazhdon me një masë alarmante, ku gjatë vitit 2022 Kosova humbi 785ha pyje, krahasuar me 520ha në vitin 2021 [24].

15.5 Përditësimi i fundit i “Librit të kuq të faunës” është bërë në vitin 2018 dhe fatkeqësisht nuk kemi më të dhëna publike të përditësuar që nga ai vit

### Situata e përgjithshme

Kosova shfaq një gamë të larmishme të ekosistemeve dhe biodiversitetit, të karakterizuar nga pozicioni i saj biogeografik tranzicional ndërmjet biomeve mesdhetare dhe kontinentale. Vendi krenohet me një mozaik të pasur habitatesh, duke përfshirë rajonet malore, zonat bregore, ligatinat dhe peizazhet bujqësore. Këtu vlen të përmenden “Malet e Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna”, të cilat janë të shpallura nga Qeveria si parqe kombëtare dhe strehojnë një grup unik të florës dhe faunës, duke përfshirë disa lloje endemike. Megjithatë, biodiversiteti i Kosovës përballlet me presione të konsiderueshme për shkak të faktorëve të tillë si fragmentimi i habitatit, praktikat e paqëndrueshme të përdorimit të tokës dhe ndotja.

Edhe pse ka sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, ajo po zvogëlohet dita ditës si pasojë e aktiviteteve ilegale dhe zjarreve pyjore. Në vitin 2022 dëmi pyjor vlerësohet të jetë 750ha. Vitet e fundit janë bërë përpjekje minimale për të adresuar këto sfida përmes iniciativave të ndryshme të ruajtjes dhe kornizave të politikave. Një kuptim gjithëpërfshirës i biodiversitetit dhe ekosistemeve të Kosovës është imperativ për studiuesit e politikave publike, pasi ai informon strategjitë e bazuara në dëshmi që synojnë arritjen e një ekuilibri harmonik ndërmjet ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit socio-ekonomik.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektivë

Ligji për  
mbrojtjen e  
bimëve

Ligji për  
rregullimin e  
tokës

Ligji për  
bujqësinë  
dhe zhvillimin  
rural

Ligji për  
gjuetinë

Ligji për  
mbrojtjen e  
varieteteve të  
bimëve

Ligji për  
mbrojtjen e  
mjedisit

Ligji për  
vlerësimin e  
ndikimit në  
mjedis

Ligji për  
produktet  
biocide

## Sfidat kryesore

- Urbanizimi, zhvillimi i infrastrukturës dhe zgjerimi bujqësor kanë çuar në fragmentimin dhe degradimin e habitateve natyrore. Kjo prish proceset ekologjike dhe zvogëlon hapësirën e disponueshme për kafshë të egra.
- Praktikrat e paqëndrueshme bujqësore, duke përfshirë bujqësinë intensive, mbikullotjen dhe shpyllëzimin, kontribuojnë në degradimin e tokës dhe humbjen e biodiversitetit. Teknikat e gabuara të menaxhimit të tokës mund të çojnë në erozion, ulje të cilësisë së ujit dhe shkatërrim të habitatit.
- Aktivitetet industriale, deponimi jo i duhur i mbetjeve dhe trajtimi i papërshtatshëm i ujërave të zeza mund të çojnë në ndotjen e ajrit, tokës dhe ujit. Kjo përbën një kërcënim si për ekosistemet tokësore ashtu edhe për ato ujore, duke ndikuar në shëndetin e bimëve, kafshëve dhe njerëzve.
- Të dhënat e pamjaftueshme për shpërndarjen e specieve, tendencat e popullsisë dhe dinamikën e ekosistemit mund të pengojnë vendimmarrjen e informuar për ruajtje. Hulumtimi i fuqishëm shkencor është thelbësor për politikatat dhe menaxhimin e bazuar në prova.



## OZHQ 16: PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FORTA

Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet

### Vlerësimi i targeteve

16.6 Shpenzimet buxhetore të qeverisë ishin 119.2% në vitin 2022 në raport me buxhetin fillestar të miratuar

### Situata e përgjithshme

Kosova bërë hapa të rëndësishëm drejt stabilitetit që nga lufta e fundit, megjithatë, incidentet e herëpashershme dhe tensionet politike vazhdojnë, veçanërisht ndërmjet shumicës shqiptare dhe pakicës serbe. Janë bërë përpjekje për të reformuar kuadrin ligjor, për të forcuar gjyqësorin dhe për të luftuar korrupsionin, duke treguar përparim në drejtësi dhe sundim të ligjit. Kapitulli II i Kushtetutës së Kosovës është i tëri për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Këtu përfshihen të drejtat politike, civile, ekonomike, sociale, kulturore, etj. Megjithatë, sigurimi i aksesit universal në drejtësi mbetet një shqetësim, veçanërisht për komunitetet e marginalizuara.

Gjatë vitit 2022, më saktësisht nga janari deri në maj, numri i vetvrasjeve dhe tentimeve për vetvrasje ka qenë më i ulët se vitet e kaluara. Përderisa në vitin 2021 numri i vetëvrasjeve ishte 44, në periudhën janar – maj 2022 numri i vetëvrasjeve ishte 9, kurse tentime 40 [25]

Në Kosovë gjithashtu ekziston një infrastrukturë ligjore e cila e dënon dhunën në familje. Ligji më i fundit që i adresohet kësaj çështjeje është ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore që u miratua në tetor të këtij viti. Përveç kësaj ekziston edhe një organ i veçantë që merret specifikisht me rastet e dhunës në familje.



Sipas Transparency International në vitin 2022, pikët e Kosovës për korrupsionin janë 41/100, krahasuar me 39 nga viti 2021, pra kemi një rritje jo signifikante. Nga 180 vende, Kosova është rradhitet e 84 sa i përket transparencës dhe korrupsionit. Për ta bërë raportimin e korrupsionit dhe rritjen e transparencës më të lehtë, Ligji kundër Korrupsionit ju garanton personave që parandalojnë, zbulojnë apo hetojnë korrupsionin gëzojnë pavarësi të plotë për qëllime të ushtrimit me efektivitet të kompetencave dhe përmbushjes së detyrimeve të tyre.

## Ligjet që përfshijnë këtë objektive

Kodi Penal i Kosovës

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Ligji për Amnestinë

Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale

Ligji për Avokatin e Popullit

Kodi i Etikës i Institucionit të Avokatit të Popullit

Ligji për Institutin e Krimeve të Kryera gjatë luftës në Kosove

Ligji për ekspertët gjyqësor

## Sfidat kryesore

- Kosova ka një popullsi të larmishme, me shqiptarët që përbëjnë shumicën dhe serbët që përbëjnë një pakicë të konsiderueshme. Tensionet historike dhe perspektivat e ndryshme për statusin e Kosovës shpesh herë janë duke rezultuar në konflikte ndëretnike dhe sfida politike.
- Peizazhi politik në Kosovë karakterizohet nga një sistem partiak i fragmentuar dhe një histori e qeverive të koalicionit. Kjo ndonjëherë mund të çojë në bllokime politike dhe të pengojë përparimin në çështjet kritike që lidhen me qeverisjen dhe institucionet.
- Ndërtimi i institucioneve të forta dhe të përgjegjshme është një proces i vazhdueshëm. Reformat në administratën publike, masat kundër korrupsionit dhe përpjekjet për transparencë janë të nevojshme për të siguruar qeverisje efektive.
- Një media e lirë dhe e pavarur është thelbësore për t'i mbajtur institucionet përgjegjëse dhe për të garantuar transparencë. Sfidat në këtë fushë përfshijnë çështje si pronësia e medias dhe ndikimi politik.
- Statusi i Kosovës si shtet pjesërisht i njohur mund të komplikojë aftësinë e saj për të marrë pjesë plotësisht në institucionet ndërkombëtare dhe për t'u angazhuar në marrëdhënie diplomatike.



## OZHQ 17: PARTNERITET PËR OBJEKTIVAT

Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i partneritetit global për zhvillim të qëndrueshëm

### Vlerësimi i targeteve

17.1 Të hyrat buxhetore për vitin 2022 ishin 2,430 milionë EURO, prej të cilave 89.24% vijnë nga të hyrat tatimore [26]

17.3 Sa i përket mbështetjes financiare për vendin tonë, niveli i investimeve të huaja direkte si përqindje e buxhetit ishte 1.25% [27], kurse remitancat përfshijnë 12.4% të PBB Reale [28].

17.4 Shërbimi i borxhit si pjesë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në vitin 2021 ishte 3.02% [29].

17.8 Për të përmirësuar përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ASK bënë matje të përdorimit të internetit dhe në vitin 2022 ka rezultuar se 79% e individëve janë përdorues të internetit.

17.13 Ka shumë variabla që mund të përfshihen në panelin makroekonomik, mirëpo për Kosovën ka të dhëna vetëm për inflacionin vjetor të çmimeve të konsumit. ASK tregon se norma vjetore e inflacionit e matur në muajin gusht 2022 krahasuar me muajin gusht të vitit 2021 ishte 13 për qind më i lartë.

17.18 Ligji nr. 04/I-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës është legjislacion kombëtar statistikor që përputhet me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare.

[26] [Ligji Nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës Së Kosovës Për Vitin 2023

[27] Investimet e huaja direkte 2008-2021, Banka Botërore. E qasshme këtu:

[https://ourworldindata.org/grapher/foreign-direct-investment-net-outflows-as-share-of-gdp?tab=chart&region=Europe&country=~OWID\\_KOS](https://ourworldindata.org/grapher/foreign-direct-investment-net-outflows-as-share-of-gdp?tab=chart&region=Europe&country=~OWID_KOS)

[28] Ekonomia e Kosovës, BQK. E qasshme këtu: <https://bqk-kos.org/eag/sq/>

[29] Borxhi si pjesë e eksporteve të mallrave dheshërbimeve, 2004-2020, Banka Botërore. E qasshme këtu:

[https://ourworldindata.org/grapher/debt-service-of-exports-of-goods-services?tab=chart&region=Europe&country=~OWID\\_KOS](https://ourworldindata.org/grapher/debt-service-of-exports-of-goods-services?tab=chart&region=Europe&country=~OWID_KOS)

17.13 Ka shumë variabla që mund të përfshihen në panelin makroekonomik, mirëpo për Kosovën ka të dhëna vetëm për inflacionin vjetor të çmimeve të konsumit. ASK tregon se norma vjetore e inflacionit e matur në muajin gusht 2022 krahasuar me muajin gusht të vitit 2021 ishte 13 për qind më i lartë.

17.18 Ligji nr. 04/l-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës është legjislacion kombëtar statistikor që përputhet me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare.

## **Situata e përgjithshme**

Që nga shpallja e pavarësisë, Republika e Kosovës ka vazhduar përpjekjet e saj për të ndërtuar marrëdhëniet e saj në nivel bilateral dhe multilateral me aktorë të ndryshëm të sistemit ndërkombëtar. Kosova është bërë pjesë e disa organizatave të rëndësishme botërore, duke përfshirë Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, Federatën Botërore e Futbollit, Federatën Evropiane e Futbollit, Komitetin Olimpik, Organizatën Botërore e Doganave dhe Marrëveshjen për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA). Përveç kësaj, ka zhvilluar marrëdhënie të mira me organizata të tjera si OKB, BE, OECD, WHO, WTO, etj.

Në dekadën e fundit, prioriteti kryesor politik i Kosovës ka qenë anëtarësimi në Bashkimin Evropian. Dialogu politik me Serbinë, filluar në vitin 2012 dhe pasuar nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Prillit në vitin 2013, ka shërbyer si hap i rëndësishëm drejt perspektivës së anëtarësimit. Megjithatë, ende nuk ka pasur zhvillime të dukshme në realizimin e këtij qëllimi.

Procesi i anëtarësimit në OKB dhe BE është ndërprerë nga vështirësitë që shkaktohen nga dy anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe pesë shtete anëtare të BE-së. Për të hapur rrugën drejt anëtarësimit, Kosova ka vënë theksin në dialogun me Serbinë, duke e konsideruar bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira me fqinjët si kushte të rëndësishme.

Marrëdhëniet e mira me fqinjët përfshijnë intensifikimin e tregtisë, inkurajimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe ideve, dhe bashkëpunimin drejt realizimit të synimeve të përbashkëta. Kosova është pjesë e disa iniciativave rajonale, duke përfshirë Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, Iniciativën Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë, Fondin për Ballkanin Perëndimor, Zyren e Bashkëpunimit Rajonal për të Rinjtë, Procesin e Berlinit dhe iniciativën e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Diskutimet dhe hapat e ndërmarra nga Kosova në kuadër të këtyre iniciativave tregojnë përkushtimin e saj drejt forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe zhvillimit të qëndrueshëm në nivelin ndërkombëtar.

## Sfidat kryesore

- Mungesa e të dhënave për raportimin mbi arritjet në OZHQ, e cila rezulton në moskoherencë mes politikave publike, OZhQ-ve dhe planifikimit buxhetor për implementimin e tyre.
- Stabiliteti rajonal dhe tensionet politike mung të pengojnë përpjekjet për të krijuar partneritete efektive dhe për të ndërmarre veprime të përbashkëta me vende të tjera të rajonit.

# REKOMANDIME PËR 4 OZHQ-TË PRIORITARE

## Shëndet i mirë dhe mirëqenie

1

Zbatimi i sistemeve të informacionit shëndetësor për mbledhjen më të mirë të të dhënave dhe monitorimin e rezultateve shëndetësore.

2

Integrimi i shëndetit mendor në sistemet e kujdesit parësor shëndetësor dhe ofrimi i mbështetjes për ata që preken nga çrregullimet e shëndetit mendor. Këtu është e rëndësishme që të shtyhet përpara ndryshimi i ligjit për shëndetin mendor.

3

Mbështetja e të drejtat të grave për shëndetin riprodhues dhe sigurimi i qasjes për të gjitha gratë në shërbimet e planifikimit familjar.

4

Zhvillimi dhe përditësimi i rregullt i planeve të reagimit ndaj emergjencave, duke siguruar koordinim ndërmjet ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe autoriteteve përkatëse.

## Pa varfëri

1

Krijimi dhe zgjerimi i programeve të mbrojtjes sociale për të ofruar një rrjet sigurie për pjesën e cenueshme të popullatës, duke përfshirë të varfërit, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Kjo mund të përfshijë programe të synuara të transferimit të parave, ndihmë ushqimore dhe akses në shërbimet bazë për të siguruar që individët dhe familjet të kenë mjetet për të përmbushur nevojat e tyre bazë.

2

Investimi në sektorë me potencial të lartë për krijimin e vendeve të punës dhe zbatimi i politikave që nxisin sipërmarrjen, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë. Kjo mund të kontribuojë në uljen e varfërisë dhe krijimin e mjeteve të qëndrueshme të jetesës.

3

Investimi në iniciativat e zhvillimit rural dhe mbështetja e praktikave të qëndrueshme bujqësore. Kjo mund të përfshijë sigurimin e fermerëve të vegjël me akses në burime, kredi dhe tregje. Forcimi i sektorit bujqësor mund të krijojë mundësi punësimi, të rrisë sigurinë ushqimore dhe të përmirësojë të ardhurat e komuniteteve rurale, duke kontribuar në uljen e varfërisë.

## Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike

1

Kosova mund të promovojë rritjen ekonomike duke e diversifikuar ekonominë e saj përtej varësisë aktuale në disa sektorë. Mbështetja e zhvillimit të industrive të tilla si teknologjia, energjia e rinovueshme dhe turizmi mund të krijojë mundësi të reja pune dhe të zvogëlojë ndjeshmërinë ndaj goditjeve ekonomike. Investimi në inovacion, kërkim dhe zhvillim mund të kontribuojë gjithashtu në një ekonomi më dinamike dhe më elastike.

2

Për të përmbushur kërkesat e një ekonomie në ndryshim, Kosova duhet të fokusohet në rritjen e aftësive të fuqisë punëtore të saj. Investimi në programet e arsimit dhe formimit profesional që përputhen me nevojat e industrive në zhvillim mund të ndihmojë për të siguruar që fuqia punëtore të jetë e pajisur me aftësitë e nevojshme për mundësitë e punësimit aktual dhe të ardhshëm. Bashkëpunimi me sektorin privat mund të lehtësojë zhvillimin e programeve që adresojnë drejtpërdrejt nevojat e industrisë.

3

Zbatimi i standardeve të punës që përfshijnë, mes shumë të tjerash, paga të drejta dhe kushte të sigurta pune. Për më tepër, krijimi dhe forcimi i mekanizmave të mbrojtjes sociale, të tilla si ndihmat gjatë papunësisë dhe mbulimi shëndetësor, mund të ofrojnë një rjet sigurie për punëtorët, duke promovuar stabilitetin ekonomik dhe mirëqenien.

4

NVM-të luajnë një rol vendimtar në rritjen ekonomike dhe punësim. Zbatimi i politikave dhe programeve që mbështesin në mënyrë specifike zhvillimin e NVM-ve, duke përfshirë qasjen në financa, shërbimet e zhvillimit të biznesit dhe mundësitë e tregut. Duke krijuar një mjedis të favorshëm për ndërmarrësi dhe duke lehtësuar rritjen e bizneseve të vogla, Kosova mund të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës dhe diversifikimin ekonomik.



## Veprimi për klimën

1

Investimi dhe përsheptimi i kalimit drejt burimeve të ripërtritshme të energjisë, si energjia diellore, era dhe hidrocentralet. Zhvillimi dhe zbatimi i politikave që mbështesin miratimin e energjisë së pastër dhe të qëndrueshme mund të kontribuojnë ndjeshëm në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe në zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

2

Kosova duhet të ketë prioritet zhvillimin e strategjive dhe infrastrukturës për elasticitetin klimatik për t'iu përshtatur ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Kjo përfshin vlerësimin e dobësive ndaj rreziqeve të lidhura me klimën, zbatimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe përfshirjen e praktikave rezistente ndaj klimës në sektorë të tillë si bujqësia, menaxhimi i ujit dhe planifikimi urban. Investimi në infrastrukturën elastike mund të ndihmojë në zbutjen e efekteve negative të ngjarjeve ekstreme të motit dhe të sigurojë qëndrueshmërinë afatgjatë të komuniteteve.

3

Ndihma ndaj fermerëve në adoptimin e praktikave bujqësore që janë miqësore për klimën, që rrisin qëndrueshmërinë ndaj kushteve klimatike në ndryshim. Kjo mund të përfshijë promovimin e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit, futjen e kulturave rezistente ndaj thatësirës dhe zbatimin e praktikave të agropylltarisë. Mbështetja e fermerëve në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike jo vetëm që rrit sigurinë ushqimore, por gjithashtu kontribuon në elasticitetin e përgjithshëm klimatik të rajonit.

4

Bashkëpunimi me vendet fqinje dhe pjesëmarrja në nismat ndërkombëtare për të adresuar çështjet ndërkufitare të klimës. Shkëmbimi i njohurive, teknologjisë dhe praktikave më të mira me partnerët rajonalë mund të forcojë përpjekjet kolektive për të luftuar ndryshimet klimatike. Pjesëmarrja në marrëveshjet dhe partneritetet ndërkombëtare përforcon përkushtimin e Kosovës ndaj veprimit global të klimës.

Ky punim u botua me mbështetjen e Fondit të vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato tëdonatorëve të INDEP-it, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo bordit